



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 988/5 Prot.

Tiranë, më 16/11 /2016

V E N D I M

Nr. 85, datë 16/11 /2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Ligjit nr. 44/2015, datë 30/04/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "Rcon - AI" Sh.p.k, Tiranë.

VËREJ SE :

Në zbatim të Urdhrit nr. 215, datë 06.10.2016, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit e Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit, "Rcon - AI" Sh.p.k (Nipt L21814018T), me objekt:

- Verifikimi i ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga ana e personit me iniciale A. S në kuadër të verifikimit të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale nga kontrolluesi gjatë ushtrimit të aktivitetit, në zbatim të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
- Plotësimi i detyrimit për njoftim, (nenet 21 dhe 22) të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar:

Kontrolluesi "Rcon - AI" Sh.p.k ushtron veprimtarinë në fushën e punimeve të ndryshme të ndërtimit, tregtim montim të paneleve diellore, oxhakë energjetikë si dhe tregti import të materialeve të ndryshme.

Kontrolluesi gjatë ushtrimit të veprimtarisë mbledh dhe përpunon të dhëna personale për kategoritë e subjekteve të të dhënave "Klientë" dhe "Punëmarrës". Për kategorinë "Klientë" kontrolluesi përpunon të dhënat personale emër, mbiemër, adresë, numër telefoni, adresa e-maili. Për kategorinë "Punëmarrës", kontrolluesi përpunon të dhënat personale emër, mbiemër, numrin e sigurimit shoqëror, adresën, numrin personal të identifikimit.

1. Në kuadër të trajtimit të ankesës, është konstatuar se kontrolluesi ka dërguar e-mail nëpërmjet adresës info@rcon-al.com për qëllim marketingu në drejtim të mailing-listave të "Universitetit Polis", për dërgimin e këtij e-maili janë përdorur adresat e Universitetit të cilat nuk përmbajnë të dhëna personale.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, provat e administruara vërtetojnë që subjekti kontrollues "Rcon - Al" Sh.p.k nuk ka përpunuar për qëllim marketingu të dhëna personale të ankuesit apo të punëmarrësve të tjerë të subjektit "Universiteti Polis", por ka përdorur të dhënat e subjektit tregtar për të cilat Ligji nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, nuk ofron mbrojtje. Kjo sjell si pasojë, rrëzimin e pretendimeve të ankuesit për paligjshmëri të përpunimit të të dhënave gjatë marketingut.

2. Në lidhje me verifikimit të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale nga kontrolluesi gjatë ushtrimit të aktivitetit Zyra e Komisionerit konstatoi se kontrolluesi "Rcon - Al" Sh.p.k nuk i informon subjektet e të dhënave personale "Klientë", mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t'i përpunojë të dhënat, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave, dhe masat e sigurisë, në kundërshtim me nenin 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar.

Gjithashtu, u konstatua se kontrolluesi në faqen e internetit <http://rcon-al.com/> nuk ka parashikuar informimin nëpërmjet rubrikës "*Politikat e privatësisë*", çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale, pavarësisht faktit nëse përpunimi bëhet në mënyrë elektronike apo manuale, dhe pavarësisht faktit nëse mbledh apo jo të dhëna personale nëpërmjet faqes online në internet, ka detyrimin që të publikojë "*Politikat e privatësisë*", pasi kontakti paraprak i çdo subjekti të dhënash realizohet nëpërmjet faqes online në internet.

Zyra e Komisionerit vlerëson se mospublikimi i "*politikave të privatësisë*" në faqen e internetit, privon subjektet e të dhënave personale nga e drejta për informim (në bazë të nenit 18) dhe të drejtat e parashikuara në kreun IV "Të drejtat e subjektit të të dhënave", të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar, duke mos u dhënë mundësi në ushtrimin e tyre dhe duke i cënuar ato.

3. Zyra e Komisionerit konstatoi se kontrolluesi nuk kishte hartuar një "Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale" në të cilën të parashikohen rregulla specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave të klientëve dhe punonjësve, sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, të drejtat e subjekteve, etj, në kundërshtim me nenin 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar.

Hartimi i rregullores është i rëndësishëm për kontrolluesin pasi përbën bazën e referimit për çdo përpunim të të dhënave, për çdo punonjës dhe përcakton standardet ligjore për garantimin e një përpunimi të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave personale. Rregullorja duhet të jetë gjithëpërfshirëse (të përfshijë çdo lloj përpunimi të të dhënave personale për çdo kategori subjektësh të të dhënave).

4. Në lidhje me objektin e dytë të Urdhrit, u konstatua se kontrolluesi ka përmbyshur detyrimin për njoftim në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar. Nga analizimi i përmbajtjes së njoftimit rezultoi se kontrolluesi nuk e kishte kryer përditësimin për ndryshim të gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave, sa i përket deklaratimit për "*Kategoritë e të dhënave personale që përpunohen*" (rubrika 4 e formularit të njoftimit). U konstatua se kontrolluesi përpunon më shumë të dhëna personale nga sa ka deklaruar (nr. e telefonit dhe adresë e-mail). Gjithashtu,

rezultoi se kontrolluesi nuk ka përditësuar njoftimin në lidhje me të dhënat e personit të kontaktit të deklaruar (rubrika 1.2) në formularin e njoftimit.

Grupi i hetimit administrativ vlerëson se detyrimi për njoftim dhe përditësimi i "Formularit të Njoftimit" është i rëndësishëm pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin që kryen kontrolluesi dhe realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjektit të të dhënave për të ushtruar në mënyrë korrekte të drejtat që i jep ligji.

Për shkeljet e konstatuara është mbajtur procesverbali i konstatimit, si dhe në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Ligjit nr. 44/2015, datë 30/04/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", u caktua ora 10.30 e datës 10/11/2016 për zhvillimin e seancës dëgjimore me përfaqësuesit e kontrolluesit lidhur me konstatimet e grupit të hetimit administrativ, përpara marrjes së vendimit përfundimtar.

Përfaqësuesit e kontrolluesi "Rcon - AI" Sh.p.k të pajisur me autorizim kanë paraqitur me shkrim pretendimet e tyre si më poshtë:

- *Nga ana e shoqërisë Rcon AL nuk i është dërguar email personit me iniciale A.S.*
- *Subjektet e të dhënave njoftohen për qëllimin e përdorimit të të dhënave, nuk mund ti marrësh të dhëna një subjekti nëse nuk shpjegon se përse do ti përdorësh. Formulari i njoftimit do përditësohet me të dhënat që nuk janë deklaruar.*

Si përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ në kuptim të nenit 39/1 shkronjat "b" dhe "dh", të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

b) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;

dh) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë.

Kontrolluesi "Rcon - AI" Sh.p.k, në formën ligjore të aktivitetit të tij tregtar është person juridik dhe sipas nenit 39/2 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, dënohet me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze, ato lidhen me të drejtën e subjekteve të të dhënave për tu informuar mbi përpunimin e të dhënave dhe masat e sigurisë në zbatim të ligjit. Gjithashtu, bazohet në bashkëpunimin gjatë ushtrimit të hetimit administrativ si dhe reagimin e kontrolluesit për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 18, 27, 29, 30, 31, 39/1/b dhe 39/1/dh, 40 dhe 41 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Dënimin e kontrolluesit "Rcon - AI" Sh.p.k me gjobë, në vlerën **20 000 (njëzetë mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
2. Dënimin e kontrolluesit "Rcon - AI" Sh.p.k me gjobë, në vlerën **20 000 (njëzetë mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
3. Në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, të kryhet përditësimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë.
4. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, të kryhet plotësimi i detyrimit të parashikuara në pikën 3 të këtij Vendimi, brenda një afati 10 ditor nga momenti i marrjes dijeni.
5. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky vendim u shpall sot më datë 16,11 2016.

Besnik DERVISHI

KOMISIONERI